

RAPORTI SHTET-FE (1912-1939)

Periudha historike 1912-1920

1.1 Shpallja e Pavarësisë dhe uniteti rreth çështjes kombëtare

Akti i shpalljes së Pavarësisë dhe i krijimit të shtetit të ri shqiptar shënon edhe krijimin e një sistemi të ri politik të mbështetur e frymëzuar në programet e rilindësve kombëtarë, të ideologëve, diplomatëve, shkrimtarëve si dhe në kontributet e klerikëve të besimeve të ndryshme, të cilët ishin të bashkuar me zërin e kombit dhe të shqiptarit për përmbushjen e idealeve të tyre¹⁷⁴.

Kuvendi i Vlorës zë një vend të një rëndësie të veçantë në memoriën historike të kombit shqiptar. Sipas studiuesit Luarasi, ai *“përfaqësonte efektivisht vullnetin e gjithë kombit dhe u bë organi më i lartë i shtetit shqiptar, mbajtësi dhe shprehësi i sovranitetit shtetëror. Prandaj vendimet e tij kishin vlerën e ligjeve kushtetuese...”*¹⁷⁵. Kuvendi mori vendime të rëndësishme, që sanksionuan vullnetin e popullit shqiptar për shkëputje nga perandoria osmane, krijoi strukturat dhe institucionet e para të cilat, për nga mënyra e formimit, kompetencat dhe aktiviteti, hodhën bazat e institucioneve politike e kushtetuese të shtetit të ri. Pas vitit 1912, me aktivitetin atdhetar që kryen, klerikët e radhitën veten midis personaliteteve politike e shoqërore dhe luftëtarëve të lëvizjes kombëtare.

Siç pritej, komunitetet fetare do të kishin një peshë të rëndësishme, në periudhën e shpalljes së Pavarësisë. Në aktet e krijimit të shtetit të ri morën pjesë një sërë personalitetesh të

¹⁷⁴ Bartel Peter: “Muslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare” (1878-1912) Dituria, Tiranë, 2006

¹⁷⁵ Aleks Luarasi: “Çështje të historisë dhe të shtetit të së drejtës”, Tiranë, 1999

tre besimeve fetare. Secili komunitet u përfaqësua edhe në qeveri e senat. Ndër vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës, ishte edhe zgjedhja e senatit, kryetar i të cilit u zgjodh kryemyftiu i Shqipërisë, Vehbi Dibra, (nënshkrues i dokumentit të pavarësisë) dhe zëvendës i tij një ortodoks. Formimi i qeverisë, gjithashtu, mbi bazën e përfaqësimit krahinor dhe fetar do të reflektonte një ndarje të barabartë midis ministrave muslimanë dhe atyre të krishterë¹⁷⁶. Në përmbushje të këtij kriteri zëvendëskryeministër i qeverisë së drejtuar nga Ismail Qemali u zgjodh përfaqësuesi i komunitetit katolik Nikollë Kaçorri (nënshkrues i dokumentit të pavarësisë).

Këto raporte u reflektuan edhe në delegacionet ndërkombëtare dhe në nivele të tjera të përfaqësimit shtetëror.

1.2 Legjislacioni i ri shtetit shqiptar

Qeveria e Vlorës u angazhua shumë për hartimin e legjislacionit të ri të shtetit shqiptar. Ajo hartoi ligje për krijimin e bërthamës së sistemit të ri të drejtësisë dhe të administrimit.

Ligjet më të rëndësishme të qeverisë së Vlorës ishin: “Kanuni i Zhurisë” (5 maj 1913) dhe “Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile” (22 nëntor 1913), dy ligje që përbëjnë aktet e para në organizimin e sistemit gjyqësor dhe organizimin administrativ të shtetit të ri shqiptar.

Kanuni i Zhurisë ishte vendimi i parë i rëndësishëm i saj në drejtim të organizimit të sistemit gjyqësor, përmes të cilit urdhërohej bashkimi i çështjeve civile me ato penale, *“suprimimi i kadillarëve dhe shikimin e padiravet fetare nga ana e myftilerëve; emërimin e një myftiu në çdo nënprefekturë me rrogë 1200 groshë e ndër prefektura me nga 1800 grosh..”*. Sipas këtij urdhri, *“vendimet e gjyqeve të Sherisë të shkruhen në gjuhën arabe. Myftitë do të vihen në provim prej hirësisë së Tij Vehbi Efendiut, Shehislamit të Shqipërisë dhe funksionimi i tyre do të dekretohet prej tij”*¹⁷⁷.

¹⁷⁶ Lef Nosi: “Dokumente historike 1912-1920”, Tiranë, 2008

¹⁷⁷ Grup autorësh: “Historia e shtetit të së drejtës në Shqipëri“, Tiranë, 2006

Në këtë mënyrë del në pah se Vehbi Dibra, i cilësuar si “Shehislami i Shqipërisë”, autoriteti me i lartë fetar i Shqipërisë, ishte i ngarkuar për të ndërmarrë këtë reformë strukturore në sistemin gjyqësor. Ky akt do të shënonte, nga njëra anë, një arritje të madhe në krijimin e pushtetit gjyqësor, pasi në dallim nga modeli osman, ai sanksiononte ngritjen e gjykatave të pavarura, duke ua hequr organeve administrative të drejtën e dhënies së drejtësisë. Nga ana tjetër, do të shënonte vendosjen e gurit themeltar të nismës për shkëputjen e Bashkësisë Islame të Shqipërisë, ende të pathemeluar, nga Khalifati i Stambollit dhe Shehislami i tij. Ky fakt publikohet edhe në një lajm të botuar në gazetën “Dielli”, organi Shoqërisë “Vatra” të Amerikës në numrin e saj 247, datë 23 shtator 1913. Në një korrespondence të saj nga Vlora bënte fjalë për ndryshimet që ishin bërë në qeveri ku, ndër të tjera, njoftohej se “Vehbi Dibra që ishte president i Senatit, u bë kryetar i Muhamedanëve (muslimanëve) dhe vendin e tij e zuri z. Ekrem Vlora”¹⁷⁸. Dihet se postin e Kryemyftiut të Përgjithshëm ai e kishte edhe në kohën kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë, por tani ai lirohet nga detyra e presidentit të Senatit për t’iu kushtuar tërësisht organizimit administrativ të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, një akt ky që do të finalizohet 10 vjet më vonë.

Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile ishte një tjetër akt me karakter kushtetues, i ndërmarrë nga qeveria e Vlorës. Qëllimi i tij ishte të rregullojë administrimin lokal, të bëjë ndarjen e re administrative dhe të përcaktojë kompetencat e autoriteteve vendore.

Mbi bazën e tij, vendi do të ndahej në prefektura, nënprefektura, krahina dhe fshatra, me një rol të rëndësishëm mbikëqyrës dhe drejtues të Ministrisë së Punëve të brendshme. Prefekti do të kishte një peshë të veçantë në vendimmarrje, ndërsa në nivel nënprefekturash do të drejtonte nënprefekti dhe një këshill i veçantë edhe me përfaqësues të komuniteteve fetare.

Gjithashtu, ky kanun konsiderohet dokumenti i vetëm zyrtar mbi nocionet e proceseve zgjedhore i trashëguar nga qeveria e

¹⁷⁸ Basha Ali: “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”, Tiranë, 2000, f. 76-78

Vlorës. Në një kapitull të veçantë mbi zgjedhjet paraqiten detajet e organizimit të procesit zgjedhor në prefektura dhe krahina, të drejtat për të votuar, për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur. Në nenin 68 përcaktohen të drejtat civile e politike, përmendet se

“të drejtë votimi të veçantë kanë fetarët, mësuesit, mjekët, gjykatësit, nëpunësit e administratës, etj”. Kështu, ndër të tjera, ky kanun përbënte një bazë të mirëfilltë ligjore, për garantimin e funksionimit të një sistemi zgjedhor ^{179]}.

1.3. Aktet ligjore në fushën e arsimit

Pavarësia e gjeti arsimin të paorganizuar në mënyrë institucionale, shkollat mbaheshin nga klerikë të bashkësive të ndryshme fetare. Nëse fëmijët muslimanë donin të shkonin në shkollë, atyre u duhej të venin në një shkollë-xhami, ndërsa fëmijëve ortodoksë u duhej të shkonin në shkolla të mbajtura nga kisha ortodokse greke, ku tekstet dhe mësimi ishin greqisht. Fëmijët katolikë, nëse donin të arsimoheshin, ishin të detyruar të ndiqnin shkollat austriake ose italiane, ku mësonin gjermanisht ose italisht etj. Fillimisht, qeveria e Vlorës i mbylli shkollat e huaja kryesisht fetare, dhe në këtë periudhë hapi 67 shkolla fillore shqipe si një hap i rëndësishëm për mëkëmbjen e shkollës shqipe mbi baza kombëtare laike^{180]}.

1.4 Periudha e princ Vidit

Sistemi politik, i vendosur në dhjetor 1912 në Shqipëri, do të ndryshonte 8 muaj më pas, më 29 korrik 1913, kur përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër morën vendimin e rëndësishëm të njohjes së të drejtës së shqiptarëve për të pasur shtet të paanshëm dhe neutral. Sipas këtij vendimi, Shqipëria të shpallej principatë me një formë regjimi monarki kushtetuese dhe në krye të saj të emërohej një princ evropian, forma e re e shtetit do të përcaktohej “nën

¹⁷⁹ Krasniqi, Afrim, “Sistemet politike në Shqipëri (1912 -2008)”, Tiranë, 2009, f. 28-30

¹⁸⁰ Instituti i Studimeve Pedagogjike. Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, pjesa i, f. 319-327

garancinë e gjashtë Fuqive të Mëdha”¹⁸¹. Patriotët shqiptarë u pajtuan plotësisht me propozimin e Fuqive të Mëdha për një princ të huaj, princ Vidin, të cilin e propozuan Austro-Hungaria dhe Italia. Të dëshpëruar nga anarkia që kishte mbuluar vendin dhe të shqetësuar për fatin e atdheut, ata mendonin se princi do ta bashkonte Shqipërinë, do ta shpëtonte atë nga rreziku i copëtimit.

Asambleja Kombëtare ishte organi i dytë më i rëndësishëm i krijuar nga Konferenca e Londrës dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ajo zëvendësoi modelin e Kuvendit Kombëtar të krijuar më 1912-ën, ndërkohë që sistemi i ri politik nuk përfshiu ngritjen dhe funksionimin e Senatit. Kompetencat kryesore të Asamblesë Kombëtare, rregullat e zgjedhjes dhe të funksionimit, u përcaktuan me “Statusin Organik të Shqipërisë”, të hartuar nga KNK-ja dhe të miratuar më 10 prill 1914. Sipas tij, Asambleja Kombëtare ishte organi ligjvënës i Principatës, ajo përbëhej nga 36 anëtarë të ndarë për shkak të detyrës, 21 anëtarë zgjedhur me votim jo të drejtpërdrejtë dhe 10 anëtarë të emëruar nga Princi. Anëtarë për shkak të detyrës ishin 4 përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe komisar i lartë shqiptar pranë Bankës Kombëtare¹⁸².

1.5 Statusi Organik i Shqipërisë, liritë dhe të drejtat e besimit dhe pozita e komuniteteve fetare (1914)

“Statusi Organik” përbën kushtetutën e Monarkisë së Parë Shqiptare, i formuluar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ai përbëhej nga 216 nene të ndarë në kapituj, përkatësisht feja trajtohet në nenet 170-177. Për shkak të nevojës për forcimin e natyrës harmonike midis komuniteteve fetare në Shqipëri, hartuesit e tij i kushtuan fesë dhe raporteve me shtetin një rëndësi të veçantë. Kështu, “Statuti Organik” sanksiononte se *“Shqipëria nuk ka fe shtetërore. Liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t’i vihet asnjëri si shkak për të përjashtuar ose për të cilësuar si*

¹⁸¹ Krasniqi, Afrim, “Sistemet politike në Shqipëri (1912 -2008)”, Tiranë, 2009, f. 37-39

¹⁸² Krasniqi, Afrim, “Sistemet politike në Shqipëri (1912 -2008)”, Tiranë, 2009, f. 54-56

të paaftë për sa i përket gëzimit të së drejtave civile e politike, pranimit në punë shtetërore, në funksione dhe ndere ose për sa i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme”¹⁸³.

Në këtë dispozitë mund të dallojmë se liria e fesë, si liri themelore e shtetasve, jo vetëm shihet e lidhur ngushtë me parimin e asnjësisë së shtetit ndaj saj, por formulohet në të njëjtën dispozitë kushtetuese, si një e tërë me të. Kështu, për herë të parë, statuti sanksionoi me ligj lirinë fetare dhe mohimin e një feje shtetërore, duke eliminuar mundësinë e konflikteve fetare midis shqiptarëve; dhe pa dyshim që ka qenë arritja më e madhe në drejtim të paqes sociale midis shqiptarëve të pamësuar në një bashkësi politike më vete.

Statuti u njihte të drejtën komuniteteve fetare të ruajnë pasuritë e tyre (neni 170) “Komunitetet fetare në Shqipëri ruajnë pronat e tyre”; (neni 171) të vazhdojnë të marrin, nën mbrojtjen e autoriteteve, të ardhurat e konsakruara nga zakoni; (neni 172) të përjashtohen nga taksat godinat që shërbejnë për kultet, për arsimin publik dhe për vepra bamirësie; (neni 174) në raste të formimit të komuniteteve të reja fetare, Shteti rezervon të drejtën e njohjes dhe të përcaktimit të të drejtave të tyre. Megjithëse ligji detyronte mësimin shqip në shkolla, në rastin e shkollave fetare lejohej mësimi në gjuhën e kultit. Neni 175 i njeht princit të drejtën të japë miratimin për klerikët dhe parinë e të gjitha komuniteteve fetare të njohura prej shtetit “Hirësit dhe dinjitozët e të gjitha komuniteteve fetare të njohura nga Shteti do të marrin veshjen me autoritet të madhërisë së tij Princit”.

Ndërkohë, Statuti theksonte se rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të bëhej me marrëveshje të posaçme midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve (neni 176). Një element i rëndësishëm i rolit aktiv të shtetit në promovimin e trashëgimisë dhe identitetit të komuniteteve fetare ishte detyrimi i shtetit për të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura si dhe të klerit, duke caktuar për këtë qëllim shumën që

¹⁸³ Roberto Maroco Della Roka. “Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 – 1944 “ 1999, f. 32

do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror. (neni 177) "I përket Shtetit të ndërmarrë masat për mirëmbajtjen e të gjitha kulteve të njohura nga ai si edhe të fiksojë një shumë, që gjykohet e nevojshme, në buxhetin e përgjithshëm të Shtetit, i cili do të marrë parasysh pronat aktuale të paluajtshme, që u përkasin këtyre kulteve".

1.6 Qëndrimi i komuniteteve fetare ndaj sistemit politik

Ardhja më 7 mars e mbretit të ri me një përkatësi tjetër fetare nga ajo e tre besimeve që ekzistonin në vend, e bënte Shqipërinë me shumicë muslimane, një rast specifik të një regjimi monarkist që ka në krye një princ protestant. Ai gëzoi mbështetje e përkrahje jo vetëm te komunitetet fetare tradicionale katolike e ortodokse, po edhe tek ai mysliman. Të dëshpëruar nga anarkia që kishte pushtuar vendin dhe të shqetësuar për fatin e atdheut, në këtë kohë shpresat i mbështetën te Princi gjerman, duke mos qenë i përfshirë në krahinarizmat dhe influencat fetare, do të ishte në gjendje të ushtronte autoritetin e lartë shtetëror në dobi të kombit. Ata besonin se ai do ta shpëtonte Shqipërinë nga rreziku i copëtimit.

Drejtuesit institucionalë të muslimanëve këtë dëshirë e aspiratë të tyre nuk ngurruan t'ia shprehnin hapur edhe princ Vidit, vetëm një javë pasi ky kishte ardhur në Shqipëri, më 14 mars 1914 - ditë kur mbreti vajti në xhami, u prit me nderime të mëdha nga besimtarët muslimanë dhe Kryemyftiu Vehbi Dibra, i cili bëri shërbesën, lutjet dhe urimet duke i uruar mirëseardhjen e tyre në gjuhën shqipe, e mbylli fjalën e tij me lutjen dhe urimin për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Por shumë shpejt Kryemyftiut iu desh të mbante qëndrim të rreptë dhe të vendosur ndaj atyre myderrizëve, hatibëve dhe myftilerëve, si të Peqinit dhe të Kavajës etj., të cilët, në maj të vitit 1914, të shtyrë nga elementë esadistë e turkomanë, duke rënë ndesh me interesat kombëtare, ngritën në krahinat e veta flamurin turk. Ai e dënoi këtë si një ngjarje që cenonte çështjen kombëtare, që synonte përçarjen, prandaj shkoi në vend dhe qetësoi situatën¹⁸⁴.

Periudha Historike 1920-1939

¹⁸⁴ AQSh. Fondi 71. Dosja 71, f. 619

2.1 Kongresi i Lushnjës

Pas ngjarjeve dramatike të vitit 1914 asnjë institucion shtetëror nuk i mbijetoi Luftës së Parë Botërore. Fillimi i viteve '20 shënoi një kthesë të rëndësishme në historinë politike të shtetit shqiptar. Pas largimit të rrezikut të jashtëm për copëtimin e Shqipërisë, shqiptarëve iu desh të kthenin forcat në zhvillimin e brendshëm të vendit, të kapërcimit të prapambetjes dhe demokratizimit e jetës së tij. Zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe kulturor i duhej paraprirë me zgjedhje të organeve qeverisëse në qendër dhe në rrethe, si dhe miratimit të një legjislacioni shtetëror aq të domosdoshëm për vendin.

Zhvillimet politike në Shqipëri, hynë në një fazë të re historike me Kongresin e Lushnjës, zhvilluar në janar të vitit 1920. Vendimet që u morën në të, patën ndikime të mëdha në jetën politike të vendit dhe ndryshuan tërësisht sistemin partiak e shtetëror, duke përcaktuar sistemin demokratik të qeverisjes dhe parimet kushtetuese të shtetit të ri duke ndjekur shembujt më të përparuar të sistemeve politike europiane. Risia më e madhe e Kongresit të Lushnjës, në aspektin e krijimit të modelit të ri shtetëror, ishte krijimi i Këshillit të Naltë të Shtetit. Në thelb, detyra e këtij institucioni do të ishte ushtrimi i të gjitha kompetencave të kryetarit të shtetit¹⁸⁵.

Në vizionin e Kongresit të Lushnjës, Këshilli i Naltë shfaqej si organi më i lartë i konceptuar si organ kolegjal i kryetarit të shtetit, me dy kompetenca themelore në ushtrimin e qeverisjes përmes emërimit të kryeministrit, si dhe shpalljes së ligjeve të miratuara në parlament.

Për mënyrën e zgjedhjes u vendos kriteri unikal i përbërjes së Këshillit të Naltë me katër anëtarë, ku secili përfaqëson një nga katër komunitetet e mëdha fetare në vend (musliman, ortodoks, katolik, bektashi). Ky Këshilli i zgjedhur me unanimitet në Lushnjë përbëhej nga Abdyl Toptani (musliman), Aqif Biçaku - Elbasani (bektashi), Dom Luigj Bumçi (katolik), Mihal Turtulli

¹⁸⁵ Kaliopi Naska. "Këshilli Kombëtar 1920", Tiranë, 2000

(ortodoks) dhe, siç shihet, katër anëtarët përfaqësojnë njëherësh Elbasanin, Shkodrën, Korçën dhe Tiranën, duke ruajtur edhe raportet krahinore të përfaqësimit.

Delegatët hartuan dhe miratuan "Bazat e Kanunores së Këshillit të Lartë", një dokument me vlera kushtetuese, i përbërë nga vetëm 6 nene. Konkretisht, "Baza e Kanunores" përcaktonte 6 parime kryesore të funksioneve të Këshillit të Naltë në raport me pushtetet e tjera^{186]}

2.2 "Zgjerimi i Statusit të Lushnjës (1922) - Dokument kushtetues"

Një nga vendimet më të rëndësishme të parlamentit të ri ishte hartimi dhe miratimi i "Zgjerimi i Statusit të Lushnjës"(1922), dokument me vlera të veçanta historike dhe kushtetuese. Për vlerat e tij, ai njihet gjerësisht si "Statusi i shtetit shqiptar". Statusi dominohej nga fryma europiane dhe demokratike e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit, natyrës parlamentare dhe garantimin e plotë të të drejtave të njeriut. Në të riafirmohej forma monarkiste e qeverisjes, edhe Këshilli i Naltë vijonte të ishte me katër anëtarë nga secili besim fetar, me mandat dyvjeçar dhe zgjedhje nga parlamenti.

Statusi parashikonte të drejta civile dhe politike për qytetarët, si dhe deklarin se në "Shqipëri nuk njihet fe zyrtare"^{187]}. Në tërësi, ndryshimet kushtetuese të vitit 1922 shënuan një ngjarje të rëndësishme në organizimin dhe modernizimin e shtetit të ri shqiptar. Ndërkohë që sistemi zgjedhor mbeti i njëjtë me atë të vitit 1921, në ligjin për organizimin e zgjedhjeve ndër të tjera theksohej se në shpalljen e deputetëve merrej parasysh edhe raporti fetar.

¹⁸⁶ Krasniqi, Afrim, "Sistemet politike në Shqipëri (1912 -2008)", Tiranë, 2009, f. 70-72

¹⁸⁷ Aleks Luarasi. "Çështje të historisë dhe të shtetit të së drejtës", Tiranë ,1999 f. 94-101

2.3 Organizimi i institucioneve fetare mbi baza kombëtare

Mjaft autorë të huaj vënë në dukje se në fillimet e viteve '20 u bënë përpjekje me rëndësi për organizimin e institucioneve fetare mbi baza kombëtare. Shteti Shqiptar e ndjeu për detyrë të ndihmonte në organizimin e institucioneve fetare dhe të nxiste e të përkrahte pavarësinë e tyre administrative e politike nga qendra të huaja me pretendime ndaj Shqipërisë. Për të arritur deri këtu kërkohet jo vetëm vullneti i forcave politike, por edhe një mirëkuptim dhe bashkëpunim me komunitetet fetare, sepse këto të fundit, gjatë sundimit osman, në kushtet e mungesës së shtetit kombëtar, krahas funksionit të ushqimit shpirtëror ndër besimtarët, ishin kthyer edhe në organizma për të administruar jetën e tyre. Për të ecur me kohën dhe në përputhje me detyrat e reja që shtroheshin përpara kombit dhe shoqërisë shqiptare, xhamia dhe kisha kishin nisur riorganizimin e tyre të pavarur nga Kalifati dhe Patrikana.

2.3.1 Themelimi i Komunitetit Musliman të Shqipërisë

Reforma strukturore nisi në vitin 1922, kur mbi bazën e kërkesave të parashtruara nga qytete të ndryshme, Gjyqi i Sheriatit kërkoi nga organet kompetente shtetërore lejen për mbledhjen e Kongresit Musliman. Gjyqi i Naltë i Sheriatit i drejtohet Kryeministrit dhe e njofton se, meqë e shikon të nevojshme një këshill (kongres - A.B.) të muslimanizëm, për të cilin është folur e kërkuar herë pas here verbalisht edhe nga ana e popullit musliman, ka caktuar që të bëhet një mbledhje për formimin e këshillit në fjalë më 20 shkurt 1923. "Me këtë rast e njoftojmë të lartën Kryeministri dhe kërkujmë prej saj të na ndihmojë, duke u dhënë urdhrat e duhura, të gjitha prefekturave e nënprefekturave që të zgjedhin rregullisht nëpërmjet bashkive nga 1 person e ta dërgojnë në Tiranë" - përfundon shkresa¹⁸⁸.

Ministri i brendshëm Ahmet Zogu u dërgon një qarkore shifër datë 11 shkurt 1923 zyrave vartëse me këtë përmbajtje:

¹⁸⁸ AQSh. Fondi 482, viti 1923, dosja 1, fleta 11

“Jeni të lutur të përpiqeni në mënyrë legale që delegatët që do të zgjidhen për me marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të muslimanizmës të jenë patriotë dhe pak a shumë liberalë”, duke e lejuar në këtë mënyrë atë organizëm të thërriste mbledhjen e përgjithshme për formimin e Këshillit të Muslimanëve.^{189]}

Në këtë Kongres, të mbajtur nga data 24 shkurt deri më 12 mars 1923, morën pjesë delegatë nga e gjithë Shqipëria. Ai ka një rendësi të jashtëzakonshme në historinë e zhvillimit të Islamit në Shqipëri: a) Duke shpallur mëvehtësimin e Xhamisë shqiptare, preu *de facto* dhe *de jure*, të gjitha llojet e lidhjeve me kalifatin dhe b) Themeloi Komunitetin Musliman të Shqipërisë, që në të ardhmen do të merrte në dorë, nëpërmjet administratës që ngriti, interpretimin teologjik dhe rregullimin administrativ të të gjitha çështjeve islame në Shqipëri^{190]}.

Gazeta “Temps” e Parisit, duke komentuar vendimet e Kongresit I të Muslimanëve të Shqipërisë për shkëputjen nga Khalifati, theksonte se “*këto masa kanë bërë përshtypje të mëdha në tërë botën muhamedane*”^{191]}.

2.3.2 Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare

Që t’i jepej fund veprimtarisë antishqiptare të Patrikanës, duhej të formohej Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Themelimi i saj është i lidhur me emrin e F. S. Nolit. Sipas porosisë së tij, në Shqipëri u bë shqiptarizimi i kishës. Më 11 shtator të vitit 1922, në Kongresin e Beratit u shpall Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ajo u sanksionua ligjërisht me miratimin e Statutit të saj më 4 dhjetor të 1923. Po në atë vit, Noli, pasi u shugurua peshkop, mori në dorë kryesinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Por Patrikana e Stambollit vazhdonte të mos e njihte atë^{192]}.

Kongresi I i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

^{189]} AQSh. Fondi 482, viti 1923, dosja 1, fleta 2

^{190]} Statuti i trupit xhema’atit Musliman Shqiptar. Tiranë, 1923. f. 3

^{191]} Basha, Ali, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve” Tirane 2000, f. 118

^{192]} Shyqyri Hysi. “Historia e komuniteteve fetare në Shqipëri”, Tiranë, 2008, f. 201

u mblodh më 15 qershor të vitit 1929. Ai miratoi Statutin e përhershëm të vitit 1929 të KOASh-it dhe dogmat universale të ortodoksizmit. Në artikullin 16 të këtij statuti kërkohet që kryepeshkopi e hierarkia e lartë kishtarë të jenë me nënshtetësi, gjak e gjuhë shqiptare. Në të thuhet: “Kryepeshkopët, peshkopët, zëvendësit e tyre lokalë... duhet të jenë prej gjaku e gjuhe shqiptare dhe të kenë nënshtetësinë shqiptare”.

Me këtë Statut nuk lejohet ndërhyrja e Patrikanës Ekumenike ose e çdo kishe tjetër në Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Qëndresa e Qeverisë Mbretërore, e popullit shqiptar dhe, sidomos e ortodoksëve të Shqipërisë ndaj ndërhyrjeve e presioneve të Patrikanës, bënë që Patrikana e Stambollit më 12 prill 1937, lëshoi tomin e Sinodit të Patrikanës Ekumenike me numër 609, me të cilin njohu botërisht Kishën tonë^{193]}.

2.3.3 Komuniteti Bektashi

Shpallja e autonomisë së bektashizmit nga qendra në Turqi u bë në Kongresin e tyre të Parë (17 janar 1921). Ky veprim u lehtësua shumë edhe nga fakti se kryegjyshi botëror i bektashinjve në atë kohë ishte me origjinë shqiptare. Largimi i tij nga Turqia qe një veprim politik dhe më vonë u vendos në Tiranë, e cila u bë zyrtarisht qendra e Bektashizmit Botëror.

Vendimet e Kongresit Musliman në mars 1923, ashtu sikurse dhe vendimet e Kongresit Bektashian të Prishtës në janar 1921 dhe të Kongresit të Kishës Ortodokse në Berat në shtator 1922, i vunë organizmat fetare të masës dërmuese të popullsisë shqiptare në vendin tonë, organizativisht dhe administrativisht, mbi baza kombëtare jashtë ndikimeve politike të huaja të dëmshme apo dhe të rrezikshme. Me këto vendime viheshin në jetë idealet e rilindësve tanë, në radhët e të cilëve militonin aktivisht dhe klerikë të këtyre besimeve, për sigurimin e bashkimit dhe vëllazërimit kombëtar të mbarë shqiptarëve pa dallim besimi. Kjo ishte dhe mbetej rruga kryesore për forcimin e traditave të mrekullueshme të tolerancës ndërfaqetare të shqiptarët^{194]}.

¹⁹³ Delvina, Sherif, “Pa pavarësi fetare, nuk ka pavarësi kombetare”, Tiranë, 1998, f. 52

¹⁹⁴ Shpuza, Gazmend, “Vendimet Kongresit I Mustiman”, kumtesë në simpozium. Tiranë, 19 maj 2006

2.4 Politika e ndjekur nga A. Zogu me institucionet fetare

Ideja e shkëputjes së shtetit nga feja dhe e barazisë së qytetarëve u realizua pas rikthimit të A. Zogut në pushtet, në dhjetor të vitit 1924. Pozita e feve në shtetin shqiptar u sanksionua në Statutin Kushtetues të Republikës Shqiptare më 1925, si edhe në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare në dhjetor të vitit 1928. Statuti Themeltar i Shtetit, në paragrafin e parë të artikullit pesë, sanksiononte ndarjen e shtetit nga feja, kështu feja nuk mund të formonte pengesa juridike.¹⁹⁵ Në të shpallej se “shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë e besimet janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe praktikimit të jashtëm të tyre është e siguruar”.

Gjithashtu, në përcaktimet e kriterëve për zgjedhjen e deputetëve apo të rregullave parlamentare gjenden edhe përcaktime të tilla si kushteve për të qenë deputet dhe për të ushtruar profesionin u shtohet papajtueshmëria me shërbimin aktiv fetar dhe rrobat fetare.

Në periudhën e parlamentit me dy dhoma, 1925-1928, mbreti gëzoi të drejtën e emërimit të një së tretës së anëtarëve të Senatit, me argumentin e balancimit prej tij të raporteve krahinore e fetare, gjë që ai faktikisht edhe e bëri. Më 1927-ën, qeveria bëri një marrëveshje me Selinë e Shenjtë, ku pranohej liria e veprimit të Kishës Katolike, e cila varej administrativisht nga Vatikani.

2.4.1 Kodi Penal dhe Kodi Civil

Në fushën e drejtësisë, sukseset e regjimit të ri u dukën shpejt. Studiues të huaj vërejnë se mbreti Zog arriti të vinte ligjin dhe rregullin në një vend që nuk i kishte njohur fare ato.

Më 8 janar 1928 hyri në fuqi Kodi Penal i hartuar sipas modelit të Kodit Penal Italian të vitit 1889. Reforma legislative u thellua me hyrjen në fuqi të Kodit Civil më 1 prill 1929. Ky kod u bazua në modelet perëndimore të kodit francez, italian, zviceran, gjerman, bashkë me ndonjë normë të marrë nga zakonet juridike

¹⁹⁵ “Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare“. Botime Zyra e Shtypit e Oborrit Mbretëror, Tiranë, 1997

shqiptare dhe nga ligjet egjiptiane në fushën e Vakëfit¹⁹⁶. Në përbërjen e komisionit ligj-përgatitës ishin një grup juristësh të përgatitur me kulturë juridike perëndimore, si: Mehdi bej Frashëri, Thoma Orollogaj, Faik bej Shatku dhe Agjah Libohova. Këta konsideroheshin si njohësit më të mirë të jurisprudencës krahasuese dhe të jurisprudencës europiane në fuqi. Kështu, statusi laik zëvendëson statusin fetar, ku bazohej juridiksioni i kishave si dhe ai i islamit në sektorë të gjerë të jetës shoqërore familjare.

Një nga pasojat kryesore të këtij Kodi ishte ndarja e fesë nga drejtësia dhe shkrirja e gjykatave fetare të trashëguara nga periudha e perandorisë osmane¹⁹⁷.

Në kuadër të këtyre masave, herë-herë ligjore apo nënligjore dhe herë të tjera administrative, mund të përmendim, p.sh., futjen e martesës civile, vendosjen e institucionit të gjendjes civile, disiplinën dhe kufizimin ligjor të divorcit, shfuqizimin e krenimit të festës së ditës së premtë, tentativën dhe inkurajimin që bëhej për kundërvënje apo përçarje ndërmjet besimtarëve muslimanë, duke krijuar në gjirin e tyre komunitete e shoqëri fetare, qoftë dhe kulturore të pavarura, disa nga anëtarët e të cilave në mënyrë të kamufluar do të ishin në opozitë për “çështje të dogmës” me shumicën e popullsisë sunite. Po kështu, martesë civile u bë e detyrueshme dhe nuk u njohën efektet juridike të asaj fetare. U ndalua poligamia, megjithëse në kuptimin e vet të mirëfilltë ajo pothuajse nuk kishte hyrë fare në Shqipëri, por ishte e shfaqur kryesisht si bigami dhe rrallë. U lejua shkurorëzimi i bashkëshortëve, duke u njohur e drejtë si për burrin, ashtu dhe për gruan¹⁹⁸.

Por Kodi Civil do të haste në kundërshtim të fortë, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në të jashtëm. Vatikanë e kundërshtoi

¹⁹⁶ Roberto Maroco della Roka. Tiranë, 1994, f. 31

¹⁹⁷ Bernd Fischer “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri” Tiranë, 1996

¹⁹⁸ Musaj, Fatmira. “Gruaja në Shqipëri 1912-1939”, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, f. 138

me forcë ligjin e ri dhe refuzoi të nënshkruante një Konkordat me Shqipërinë, nëse do të sanksionohej me ligj divorci, por Zogu u përgjigj se nuk do të lejonte krijimin e partive opozitare në vend dhe njoftoi arkipeshkvin e Shkodrës se çdo prift, entuziazmi i të cilit për mbrojtjen e vendimit të Vatikanit do t'i kapërcente kufijtë, do të dënohej me varje¹⁹⁹.

2.4.2 Ligji mbi komunitetet fetare

Ky ishte njëri nga ligjet kryesore, që u miratua nga parlamenti më 16 korrik 1929, ndaj të cilit pati reagime të ashpra nga disa komunitete fetare, veçanërisht ai katolik, ndërsa komuniteti ortodoks, megjithëse u prek prej ligjit, nga shkak i ndodhive të turbullta që po zhvilloheshin në ato kohë brenda kishës së tyre, e pranoi ligjin. Nëpërmjet këtij ligji u shpall liria e ndërgjegjes dhe e fesë si dhe garantimi i saj.

Ministria e Drejtësisë, me projektin e përgatitur, ka ndaluar komunitetet fetare të merren me politikë dhe të ushtrojnë të drejta gjykimi (neni 3), gjë e cila u është ngritur me Statutin Themeltar e me ligjet e reja. Statutet e komuniteteve fetare, të hartuara dhe të miratuara në bazë të këtij projekti, formojnë detyrim ligjor për komunitetin që i përkasin (neni 5). Kryetarët dhe paria e komuniteteve duhet të jenë shqiptarë prej race, gjuhe dhe të kenë fituar shtetësinë shqiptare; të mos jenë të njohur si antikombëtarë dhe të kenë mbushur të paktën 25 vjeç (neni 7)²⁰⁰.

Sipas ligjit, statutet e komuniteteve fetare duhet të miratoheshin, së pari, nga qeveria dhe më pas do të dekretoheshin nga sovrani. Po e njëjta procedurë do të ndiqej edhe me titullarët drejtues të komuniteteve, të cilët duhet të ishin me shtetësi shqiptare dhe të njihnin mirë gjuhën shqipe. Buxheti i komuniteteve fetare miratohej, gjithashtu, nga qeveria,

¹⁹⁹ Bernd Fischer. "Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri" Tiranë, 2004, f. 116

²⁰⁰ AQS, Fondi 155, viti 1931 dosja VIII-136. Dekret ligji është botuar në gazetën zyrtare nr 38, e marte 16 korrik 1929

e cila kishte të drejtë të kontrollonte gjendjen e pasurive dhe të të ardhurave të tyre. Komuniteteve fetare u ndalohej marrja e ndihmave (subvencioneve) nga shtetet e huaja dhe kjo ndihmë mund të lejohej vetëm pasi të vërtetohej se kishte vetëm qëllime filantropike, gjithnjë pasi të miratohej nga qeveria²⁰¹.

Komunitetet fetare mund të merrnin leje nga qeveria për të hapur shkolla fetare, me kusht që, në programet e shkollave që do të lejoheshin të hapeshin, të kishte lëndë apo tema mësimore që do t'i shërbenin edukimit atdhetar të besimtarëve. Dhe, së fundi, renditet lejimi i përdorimit të uniformës fetare vetëm për funksionarët zyrtarë të besimit. Morëm vetëm disa nga nenet e këtij ligji, i cili, sikurse u evidentua, hapi rrugën për masa të tjera ndaj besimeve fetare, veçanërisht ndaj fesë islame. Sikurse e konfirmon studiuesi R. Morozzo della Rocca, "komuniteti musliman u prek më rëndë nga ligji dhe ndaj atij komuniteti u tregua kujdes që të adoptohej mirë"²⁰².

2.5 Aspekti arsimor dhe social

Në këtë periudhë, politika e laicizmit synonte të pakësonte ndikimin e feve të ndryshme brenda vendit, sepse edhe nëpërmjet tyre krijoheshin mundësi për ndërhyrjen e fqinjëve në punët e brendshme të Shqipërisë. Politika e ndjekur prej tij, i çonte bashkësitë fetare në varësi të pushtetit shtetëror, që merrte përsipër rolin e garantit të besimeve të ndryshme.

Në tri kongreset arsimore (1920, 1922, 1924) mbizotëroi mendimi se nëpërmjet mësimit të fesë, nga ana e mësuesve që mund të vinin nga shtetet e huaja fqinje, mund të kishte ndërhyrje dhe edukim të papërshtatshëm me politikën e shtetit. Ideja e shtetëzimit të shkollave u hodh në vitet 1922-1923 dhe vazhdoi gjatë, derisa u realizua në vitin 1933²⁰³.

²⁰¹ AQS, Fondi 155, viti 1931 dosja VIII-136. Dekret ligji është botuar në gazetën zyrtare nr 38, e marte 16 korrik 1929

²⁰² Roberto Maroco della Roca. Tiranë, 1994, f. 94

²⁰³ Instituti i Studimeve Pedagogjike. Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, pjesa I, f. 319-327

Në vitin 1933 me një amendament kushtetues, shteti mori të drejtën ekskluzive për arsimimin e qytetarëve të tij. Nacionalizimi i sistemit arsimor kishte për qëllim të pengonte përhapjen e shkollave të sponsorizuara drejtpërdrejt nga qeveria italiane për katolikët e Veriut, mirëpo në këtë mënyrë u mbyllën edhe shkollat greke, rumune si edhe Shkolla Amerikane e Korçës.

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1930, të kryer në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar si anëtar i Lidhjes së Kombeve, sipas së cilit duhet të kryente regjistrim të popullsisë në çdo 5 vjet, Shqipëria numëronte rreth 1.1 milionë banorë, nga të cilët 696 mijë muslimanë, 200 mijë ortodoksë dhe 105 mijë katolikë. Po ashtu, në të njëjtën periudhë numëroheshin 1127 xhami, 260 teqe, 844 kisha, 70 manastire, 147 kisha katolike nga të cilat 124 në Shkodër dhe rrethinat e saj. Qeveria e kohës përfshiu edhe pyetje rreth besimit fetar, gjë që realizohej në përgjithësi në të gjitha llojet e regjistrimeve të popullsisë që realizoheshin në vende të tjera. Sipas shifrave të këtij regjistrimi, muslimanët së bashku me sektet e tyre ishin 696.000 vetë, ortodoksët 200.000 vetë dhe katolikët 105.000 vetë. Tradicionalisht, raporti midis këtyre tri grupeve të mëdha fetare është konsideruar me rreth 70%, 20% dhe 10%. Përveç këtyre ndarjeve kryesore, shifrat për kategoritë e tjera kanë qenë: çifutë 204 vetë, protestantë 72 vetë dhe “të tjerë” 85 vetë, nga të cilët 24 u vetëdeklaruan ateistë²⁰⁴.

Më 1937-ën, qeveria, në kuadrin e reformave, mori vendimin e saj për ndalimin e poligamisë dhe heqjes së perçes tradicionale për gratë muslimane. Ndërsa në këndvështrimin e diversitetit fetar u inkurajua nga shteti politika e mbretit Zog lidhur me hebrenjtë në Shqipëri. Komuniteti hebre në Shqipëri u njoh zyrtarisht në prill të vitit 1937.

2.6 Reforma dhe besimet fetare

Monarkia realizoi një reformë të thellë në çështjet fetare. Faktet dëshmojnë se mbreti Zog këmbënguli që shteti të ishte asnjans, pa fe zyrtare, sepse ai deshi që feja të mos ishte

²⁰⁴ Gazeta “Besa”, 19 shtator, 1934, f. 3

mekanizëm i të huajve. Synimi afatgjatë ishte krijimi i komuniteteve fetare shqiptare të pavarura nga ndikimet fetare, politike apo financiare të shteteve të tjera, dhe me këtë eliminimi i hapësirave të mundshme për keqpërdorimin e fesë për synime politike.

Sipas studiuesit italian Roberto Monroco dela Roka nën regjimin zogist nuk ekzistonte një fe zyrtare dhe formalisht ndarja ndërmjet shtetit dhe fesë ishte absolute, megjithatë presionet qeveritare mbi bashkësitë fetare ishin shumë të forta. Zogu ndoqi një politikë laicizmi, që synonte të pakësonte ndikimin e feve të ndryshme brenda vendit. Njëkohësisht u përpoq që ato të vareshin nga pushteti shtetëror, i cili merrte përsipër rolin e garantit të besimeve të ndryshme. . . Në mënyrë të veçantë, Zogu kishte marrë masa për të afirmuar epërsinë e tij dhe të shtetit mbi fetë e ndryshme të vendit. Për kishte qëllim, edhe ndaj bashkësive fetare kishte ndjekur politikën e tij të preferuar me joshje dhe kanosje, me lëshime dashamirëse dhe me diktate të papritura, me inkurajime dhe kontrollle. Nënshtrimi i bashkësive të ndryshme fetare ndaj qeverisë dhe juridiksionit të saj ishte ndjekur edhe me mjete legjislative, zbatimi i të cilave bëhej në mënyrë arbitrare, sipas vullnetit të shprehur herë pas here nga pushteti qeveritar.^{205]}

Sikurse e evidentuam, gjatë viteve të monarkisë, mbreti nuk mundi t'i zbatojë plotësisht ligjet për bashkësitë fetare. Për sa u përket katolikëve, ata, në shumicën e rasteve, i injoruan. Në të vërtetë, katolikët, ndryshe nga muslimanët, refuzuan t'u nënshtroheshin dekretive mbretërore që kishin lidhje me çështjet fetare, sikurse ishte dekreti i korrikut të 1929-ës për formimin e bashkësive fetare. Selia e Shenjtë vazhdoi të kishte me katolikët shqiptarë jo vetëm lidhje shpirtërore, por, ç'është edhe më e rëndësishme, edhe administrative e financiare, ndërsa elementët joshqiptarë vazhduan të ishin të pranishëm në klerin katolik që vepronte në Shqipëri.

²⁰⁵ Roberto Moroco della Roca. "Kombi dhe feja në Shqipëri", Tiranë, 1994, f. 129-130; 131-132

Mbreti Zog me bindjet e tij perëndimore, gjatë sundimit të vet i hyri një rrugë reformash për të realizuar një revolucion, që ai e mendonte se do të modernizonte raportet midis shoqërisë civile dhe besimeve fetare. Mund të themi që këto reforma ishin deri diku të suksesshme, sepse vendosën një shenjë barazimi midis 4 besimeve tradicionale në vendin tonë. Por edhe pushtimet që depërtuan në Shqipëri (fashist dhe nazist) u munduan të ruajnë njëfarë balance dhe ekuilibri në raportet shtet-fe, por padyshim që depërtimet e huaja ruanin njëfarë supermacie në raportet fetare.

3. Përfundime

Raportet e marrëdhënieve shtet-fe, në secilën prej sistemeve politike dhe qeverisëse, kanë zënë një vend të rëndësishëm gjatë gjithë rrjedhës historike që nga momenti i krijimit të shtetit shqiptar e deri në ditët e sotme. Në dy etapat e para, ato të krijimit dhe forcimit të shtetit shqiptar (1912- 1920-1925) raportet fetare patën një rëndësi të veçantë. Kriteri fetar u respektua në zgjedhjen e një sërë institucionesh, përfshirë edhe Senatin, Këshillin e Lartë dhe qeveritë. Një tjetër karakteristike e dokumenteve kushtetuese dhe e sistemeve politike në raport me besimet fetare, ishte përfshirja e dukshme në jetën politike dhe vendimmarrje e figurave fetare. Edhe në zgjedhjen e parlamentit 1921 dhe 1923, u aplikuan forma të ndarjes konsensuale e paraprake të numrit të mandateve parlamentare mbi bazën e raporteve fetare.

Një nga reformat më të rëndësishme të shtetit të ri ishte edhe sanksionimi i parimit të laicitetit të shtetit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të besimit (periudha 1914-1920). Në stadin e dytë, respektivisht në Statutin e vitit 1922 dhe në aktet e tjera të mëvonshme kushtetuese, do të sanksionohej ndalimi i përdorimit të fesë për qëllime politike, ndarja e komuniteteve fetare nga jeta politike dhe krijimi i institucioneve fetare mbi baza kombëtare shqiptare. Kështu, gjatë harkut kohor të viteve 1921-1923, me mbështetjen edhe shtetërore, u organizuan kongreset e tri komuniteteve fetare (musliman, ortodoks dhe bektashi) për mëvetësimin e tyre nga qendrat e huaja.

Gjithashtu, evidentohet se legjislacioni i periudhës së monarkistë sanksionoi parimet e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit fetar, laicitetit të shtetit, kontrolli shtetëror mbi komunitetet fetare si garanci e ndalimit të hapësirave për përçarje fetare. Në këtë mënyrë, të gjithë krerët e komuniteteve fetare emëroheshin me dekret mbretëror, funksionarët e lartë duhet të ishin shtetas shqiptarë, kufizohej marrja e ndihmës së huaj, statutet e komuniteteve fetare duhej të miratoheshin nga qeveria duke realizuar për rrjedhojë edhe ndalimin e ndikimit të jashtëm ndaj tyre.

Politika e ndjekur gjatë regjimit komunist ishte ajo e kontrollit politik, indoktrinimit të gjithanshëm ateist, persekutimit si dhe ajo e fushatës frontale e komplekse të luftës kundër fesë, klerit e institucioneve fetare. Kushtetuta e vitit 1976 do të sanksiononte përfundimisht se *“shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor”*, duke e shpallur Shqipërinë të vetmin shtet ateist në botë.

Me rënien e sistemit komunist dhe krijimin e sistemit demokratik shumëpartiak, në vitin 1991 shteti njohu legjitimitetin e komuniteteve fetare dhe mbështeti ringritjen e tyre. Në dokumentet themelore të shtetit të ri demokratik u sanksionua fakti se shteti nuk ka fe zyrtare dhe se liria e besimit dhe e ndërgjegjes është e garantuar dhe e mbrojtur. Kështu, dokumenti më i rëndësishëm ligjor ishin *“Dispozitat Kryesore Kushtetuese”* të vitit 1991. Në nenin 7 të tyre theksohej laiciteti i shtetit shqiptar dhe detyrimi që shteti të respektojë *“lirinë e besimit fetar,, dhe të krijojë “kushte për ushtrimin e tij”*. Komunitetet fetare u ringritën, u ndërtuan objekte të shumta fetare dhe lindi një marrëdhënie e re midis shtetit e këtyre komuniteteve.

Në dallim nga koha e pavarësisë dhe më pas e forcimit të shtetit, në periudhën e sotme të sistemit demokratik, komunitetet fetare nuk angazhohen në jetën politike.

Në kushtetutën e vitit 1998 iu kushtua një vëmendje e veçantë parimit të laicitetit të fesë dhe garantimit të lirive, të

drejtave të besimit dhe pozitive të bashkësive fetare për të qenë persona juridikë, si dhe pavarësisë së plotë të tyre në raportin e marrëdhënieve të tyre me shtetin.

Janë ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkësive fetare për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella. Por në këtë tranzicion të tejzgjatur kanë mbetur ende pa u hedhur hapa të rëndësishëm në respektim të parimeve të shtetit të së drejtës dhe konsolidimit të një tradite vlerash demokratike.

Shqipëria gjatë kësaj periudhe 100-vjeçare është karakterizuar nga mungesa e stabilitetit të qëndrueshëm politik. Ndryshimi i sistemeve politike e qeverisëse dhe i dokumenteve kushtetuese janë argumente që tregojnë për brishtësinë e shtetit të së drejtës, mungesën e një tradite të kulturës demokratike. Në këtë kontekst, edhe raportet e marrëdhënieve shtet-fe në çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut nuk kanë qenë konstante dhe të harmonizuara me respektimin e parimeve të laicitetit. Ato janë relativizuar në varësi të zhvillimit të parametrave demokratikë të sistemeve të ndryshme politike, për rrjedhojë ky proces i marrëdhënieve ka njohur stadi të ndryshme të zhvillimit të tij nga ai i respektimit të lirive e të drejtave të besimit e deri te cenimi dhe mohimi absolut i tyre.

Në shtetin e së drejtës, laiciteti i shtetit në çështjet e ndërgjegjes dhe të fesë është dhe mbetet parimi demokratik, që garanton që të ekzistojnë së bashku të gjithë ata komponentë që nuk cenojnë parimin themelor, lirinë e përbashkët. Ndërtimi i tij është një produkt i angazhimit qytetar. Ai nuk përfaqëson vetëm një kontribut të institucioneve shtetërore, por edhe një kontribut të të gjithë aktorëve në vend, duke përfshirë individët, shoqërinë civile dhe komunitetet fetare. Nëse feja nuk e bën ligjin pronë shpirtërore të njerëzve, ligji mund të vazhdojë të ekzistojë, por vetëm si një akt i huaj për ndërgjegjen. Porositë e fesë përfshijnë respektimin për rregullimin dhe harmoninë në mes njerëzve, ndëshkimin e veseve dhe të mëkateve, ku ndër të tjera hyjnë cenimet e paqes dhe të qetësisë në shoqëri. Feja ka parimet e veta, ka detyrat që ka qytetari ndaj ligjeve që mund të aplikohen

duke i interpretuar në gjuhën fetare²⁰⁶.

Por edhe ligji duhet të bëjë për fenë, jo vetëm për të garantuar lirinë e ushtrimit të saj nga çdo individ besimtar, por edhe si institucion. Nuk mund të imagjinohet zbatimi i një ligji, kur bindjet fetare e kanë minuar atë. Shteti është i interesuari i parë për këtë marrëveshje. Komunitetet fetare nuk janë nën shtetin, por krahas tij. Në demokracinë e sotme të gjithë janë nën të drejtën, që është, në radhë të parë, tërësia e të drejtave themelore të individit. Shteti është i së drejtës, ndërsa e drejta s'është vetëm e shtetit, por e të gjithëve.

Shqipëria vendi i tolerancës, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfitare është ende në provë, në sfidën e saj për të garantuar respektimin, funksionimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe sistemin e vlerave të tij, në fushën e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Literatura e shfrytëzuar

Krasniqi, Afrim. "Partitë politike në Shqipëri, 1912 -2006", Tiranë, 2007

Swire, Joseph. "Ngritja e nje mbretërie" Përktheu Kujtim Ymeri, Shtëpia Botuese Dituria; Tiranë, 2005.

Salleo, Ferdinando. "Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri". Përktheu Virgjil Muçi.

Botuar nga Shtëpia e Librit dhe Komunikimit dhe Instituti Italian i Kulturës, 2001.

Eqrem bej Vlora. "Kujtime 1885-1925". Botimi Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2003.

²⁰⁶ Kristaq Traja. "Feja dhe e drejta si komponentë të rendit social", Konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2003